



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjeño/Prodato Received/Delivery	27.02.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	2129/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.64/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.64/2023 të datës 13.01.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kompensim i shtesave të IT-së", duke vepruar sipas nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 27.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.64/2023 e datës 13.01.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 13.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 255/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës për zyrtar të teknologjisë informative sipas Vendimit me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerën prej 200 Eurove, duke filluar nga data 26.10.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 255/2023 të datës 13.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për shtesë në pagë për IT e datës 14.12.2022 nga ankuesi për Komisionin për Shtesa për IT; Kërkesën për shtesë në pagë për IT e datës 21.06.2019, 25.03.2021 nga Drejtoresh e DFSHP e Ministrisë së Infrastrukturës për



Komisionin për Shtesa për IT; Vendimin me Nr. 01/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Aneksi I; Akt Emërimit të datës 26.10.2018 të ankuesit; Diplomën me Nr.1130 të datës 17.05.2013 të ankuesit; Certifikatën e trajnimit për periudhën 05-09.03.2018; Kërkesë për sigurimin e mjeteve për shtesa në pagë për IT nga ankuesi e datës 11.06.2019 për Sekretarin e Përgjithshëm; Emailin e datës 09.09.2020 nga [] për [] dhe []; Listën e pagave për muajin nëntor 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e palejuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 26.10.2018 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative*.

Me tej nga provat e kësaj çështje rezulton së Drejtoresha e Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme e Ministrisë së Infrastrukturës më datë 21.06.2019 dhe 25.03.2021 i ishte drejtuar Komisionit për Shtesa për IT me kërkesë për shtesë të IT-së lidhur me ankuesin, mirëpo që nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje nga Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave lidhur me kërkesat e parashtruar, ndërsa ankuesi më datë 14.12.2022 ka parashtruar kërkesë me bazë të njëjtë të Komisioni për Shtesa të IT-së, kurse me datë 13.01.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar mbi të drejtën e kompensimit të shtesës mbi pagën bazë për zyrtar të teknologjisë informative sipas Vendimit me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerën 200 Euro, në mënyre retroaktive nga data 26.10.2018.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 të të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ..."* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e datës 13.01.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, pasi që ankuesit ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 14.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se:



"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji."


Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.64/2023

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrinë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

